



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 949/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Nuk akreditohet** programi i studimit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.
 1. *Matematikë Arsimore, BSc, 180 ECTS.*
- II. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për moszbatim të këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Matematikë Arsimore, BSc, 180 ECTS</i> Riakreditim	Xhevdet Thaçi Ekrem Alimi Arbona Xhemajli

Me qëllim të vlerësimit të këtij programi të studimit, AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan me këtë përbërje: Peeter Normak dhe Asnate Kažoka. Vizita është organizuar më: 27.04.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Matematikë Arsimore, BSc*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht një (1) dhe pjesërisht pesë (5) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 101 të mbajtur më 30.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.




Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë